



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	1996/2018
Data Datum Date	18-06-2018
Nënshkrimi Potpis Signature	
PRISHTINË, PRISHTINA, PRISHTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

18.06.2018, Prishtinë

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTET PËR NDËRMARRËSI**

Bazuar në Rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të si dhe bazuar në Vendimin nr. 1812/2018 të datës, 01.06.2018 të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për thirrjen publike për Projekte për Rritjen e punësimit të rinjve përmes zhvillimit të ndërmarrësisë, ftojmë Organizatat Jo Qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit në cilësinë:

- Përfaqësues nga OJQ-të (një anëtar)

-Përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit (një anëtar)

Përfaqësuesit e lartcekur, do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve për ndërmarrësi, të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të shpallur me datë 05.06.2018.

Të interesuari për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të Ftesës Publike:

1. Përvojë në përgatitjen dhe / ose zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. Përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;
3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare në fushën e Rinisë;
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon Ftesa Publike;
5. Njohja e metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën e ndërmarrësisë për të rinj;
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur Ftesa Publike;

7. Njohja e përgjithshme e punës së MKRS/DiR si dhe njohuri në fushat në të cilat është hapur Ftesa Publike.

Afati për aplikim është deri me datë, **25.06.2018**. CV duhet të dërgohen në e-mail adresën si vijon: burim.mexhuani@rks-gov.net dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**